



NGA MONITORIMI VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE 6-27 nëntor 2006

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

1. Gjatë periudhës 6-27 nëntor 2006 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar gjithsej 9 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Në 9 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 620 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 69 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm kryesisht vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Në mbledhjen e datës 7.11.2006 ka qenë i pranishëm edhe Ministri i Financave z. Ridvan Bode për të mbrojtur projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Ndërsa në mbledhjen e datës 20.11.2006 kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të Bashkive, Komunave dhe Qarqeve për të dhënë mendimin e tyre për projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007".

(Vijon në faqen 2)

RASTEVËZHIMI Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

Projektligji "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë"

Projektligji "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë" është depozituar në Kuvend më datë 21.09.2006 dhe është përfshirë në programin e punimeve të Kuvendit më datë 6.11.2006. Ky projektligj është paraqitur nga Qeveria me propozim të Ministrisë së Ekonomisë. Është parashikuar që të shqyrtohet në kalendarin 3-javor të periudhës 16 tetor - 6 nëntor dhe 6-27 nëntor 2006.

Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji është Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Për këtë projektligj ka dhënë mendim edhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Për këtë projektligj Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar gjithsej 2 mbledhje përkatësisht më datë 30.10.2006 dhe 31.10.2006 me një

(Vijon në faqen 4)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Monitorimi i Veprimtarisë së Komisioneve Parlamentare për periudhën 6-27 nëntor 2006

faqe 1-3

2. Raste vëzhgimi: Procesi i shqyrtimit të projektligjeve të veçanta

faqe 4

3. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin nëntor 2006

faqe 5

4. Projektligje në proces Projektligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

faqe 6-11

5. Kalendarit 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë

27 nëntor-18 dhjetor 2006

faqe 1-12-14

KALENDAR I

**3 Javor (27 nëntor - 18 dhjetor 2006) i Punimeve të Kuvendit
Sesioni i III-të, Legjislatura e XVII-të**

E Hënë, datë 27.11.2006, ora 17.⁰⁰

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 23.11.2006.
3. Miratimi i Kalendarit të Punimeve të Kuvendit për periudhën 27 Nëntor – 18 Dhjetor 2006.
4. P/Ligji "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007" (nen për nen).
5. P/Ligji "Për dhënie amnistie".

(Vijon në faqen 12)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

6-27 nëntor 2006

(Vijon nga faqja 1)

3. Gjatë këtyre tre javëve (6-27 nëntor 2006) është konstatuar se deputetët kanë qenë më të informuar dhe më aktivë krahasur me periudhat e mëparshme, kjo ndoshta edhe për faktin se në mbledhjet e komisionit është diskutuar për projektligje të rëndësishme si: projektligji "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007"; projektligji për disa ndryshime në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor. Edhe gjatë këtyre tre javëve është konstatuar se deputetët nuk janë të informuar paraprakisht për projektligjet me objekt ratifikim marrëveshjesh ndërkombëtare dhe nuk kërkojnë informacion për detyrimet që rrjedhin nga ky dokument. Në 9 mbledhje të realizuara numërohen rreth 41 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 5 amendamente gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme.

4. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve. Gjithashtu deputetët vazhdojnë të vijnë me vonesë në mbledhje dhe si rrjedhojë edhe mbledhjet fillojnë me vonesë. Edhe gjatë kësaj periudhe është konstatuar se numri i deputetëve të pranishëm në mbledhje është më i vogël se numri i deputetëve të pasqyruar në procesverbal. Mesatarisht mungojnë 5 deputetë për mbledhje. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore me grupe interesi ose subjekte të tjera joqeveritare si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

5. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Siç rezulton nga monitorimi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka një pjesëmarrje të rregullt të deputetëve në mbledhjet e komisionit. Deputetët vijnë me vonesë dhe largohen përpara mbylljes së mbledhjes. Gjithashtu, nga verifikimi i procesverbalit dhe informacionit të marrë gjatë monitorimi rezulton se numri i deputetëve që mungojnë është më i madh se ai i paqyruar në procesverbal. Përsa i përket pjesëmarrjes në diskutime dhe informimit paraprak të deputetëve për projektligjet, është konstatuar se deputetët informohen paraprakisht vetëm për projektligjet e rëndësishme. Krahasuar me punimet e kalendarit të kaluar deputetët në përgjithësi kanë qenë më aktivë dhe më të informuar. Gjatë këtyre 3 javëve janë zhvilluar më shumë mbledhje se në kalendarin e kaluar dhe është konstatuar një rritje e ndjeshme e kohëzgjatjes së mbledhjeve. Si rrjedhojë janë zhvilluar më shumë diskutime dhe debate nga deputetët. Edhe gjatë kësaj periudhe komisioni është mbështetur kryesisht në ekspertizën e qeverisë dhe vetëm më datë 20.11.2006 kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues të grupeve të interesit (përfaqësues të Bashkive, Komunave dhe Qarqeve për të dhënë mendimin e tyre për projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Mbështetja e Komisionit, gjatë shqyrtimit të çështjeve, vetëm në burimin e informacionit të qeverisë pengon komisionin për të bërë një vlerësim më të gjerë të çështjeve nga shumë këndvështrime dhe duke konsultuar burime të ndryshme.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

1. Gjatë periudhës 6-27 nëntor 2006 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka zhvilluar gjithsej 11 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar dhe janë zhvilluar të gjitha sipas parashikimit. Mbledhjet e zhvilluara gjatë këtyre tre javëve kanë pasur për objekt diskutimi projektligjin "Për buxhetin e shtetit për vitin 2007". Kohëzgjatja meatare e mbledhjeve të monitoruara është 95 minuta. Gjatë këtyre tre javëve janë zhvilluar gjithsej 1050 minuta punë efektive në komision. Krahasuar me kalendarin e kaluar kjo shifër vlerësohet të jetë 3 herë më e madhe.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm përfaqësues të Këshillit të Ministrave. Në disa mbledhje kanë qenë të pranishëm edhe disa ministra për të mbrojtur buxhetin për ministritë përkatëse. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë ose burim tjetër, gjatë mbledhjeve të zhvilluara. Në mbledhjet e zhvilluara ka pasur shumë debate dhe diskutime kryesidht nga deputetët më aktiv. Pjesa tjetër e deputetëve mjaftohen vetëm me pyetje informuese. Në 11 mbledhje të realizuara numërohen rreth 60 diskutime nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 7 amendamente kryesisht teknike. Nga këto amendamente 4 prej tyre janë propozuar nga i njëjti deputet. Pjesa më e madhe e deputetëve nuk kanë informacion paraprak për projektligjet e shqyrtuara në komision.

3. Edhe gjatë punimeve të këtij kalendarit është konstatuar një pjesëmarrje më e lartë e deputetëve në mbledhje mesatarisht kanë qenë të pranishëm 14 deputetë për mbledhje nga 17 që ka gjithsej komisioni.

4. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

5. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media e cila ka qenë gjithmonë prezente gjatë diskutimit të projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007".

Disa vlerësime: Gjatë punimeve të parashikuara në këtë kalendar është konstatuar një pjesëmarrje më e lartë e deputetëve në mbledhje.

Objekt diskutimi për mbledhjet e zhvilluara gjatë punimeve të këtij kalendarit ka qenë kryesisht projektligji "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Siç rezulton nga monitorimi janë zhvilluar më shumë diskutime dhe janë propozuar edhe më shumë amendamente se në punimet e kalendareve të para të këtij sesioni. Megjithatë debatet, diskutimet si dhe amendamentet janë bërë përsëri nga të njëjtët deputetë, ndërsa pjesa tjetër e deputetëve vazhdojnë të qëndrojnë pasiv ose mjaftohen vetëm me pyetje informuese. Në ndryshim nga periudhat e tjera gjatë mbledhjeve në disa raste debatet me deputetëve kanë qenë shumë të ashpra deri edhe në fyerje. Edhe pse objekt diskutimi ka qenë projektligji "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007," konstatohet se deputetët mbështeten vetëm në burimin e informacionit të qeverisë e cila në disa mbledhje është përfaqësuar edhe në nivel ministrash. Edhe gjatë kësaj periudhe në mbledhjet e komisionit nuk kanë marrë pjesë grupet e interesit.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

1. Gjatë periudhës 6-27 nëntor 2006 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar gjithsej 7 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Në një nga mbledhjet e zhvilluara është ndryshuar objekti në fillim të mbledhjes. Kohëzgjatja mesatare e mbledhjeve të zhvilluara ka qenë rreth 44 minuta. Gjithsej janë zhvilluar 308 minuta punë efektive në komision.

2. Në përgjithësi edhe gjatë kësaj periudhe gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Në mbledhjen e datës 22.11.2006 me objekt projektligjin për Median i pranishëm ka qenë edhe Kryetari i KKRT z.Ledi Bianku. Në ndryshim nga periudhat e mëparshme gjatë këtyre mbledhjeve deputetët kanë qenë të informuar paraprakisht dhe më aktiv gjatë diskutimeve. Megjithatë në këtë komision ka nga ata deputetë të cilët

(vijon në faqen 3)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

6-27 nëntor 2006

(Vijon nga faqja 2)

nuk aktivizohen asnjëherë. Në 7 mbledhje të realizuara numërohen rreth 12 diskutime të cilat janë zhvilluar kryesisht gjatë diskutimit të projektligjit "Për Buxhetin e shtetit të vitit 2007". Gjatë këtyre mbledhjeve janë propozuar edhe amendamente. Por vetëm 1 prej tyre ka qenë me karakter thelbësor.

3. Në 7 mbledhjet e zhvilluara janë konstatuar përsëri mungesa të deputetëve të cilat krahasuar me kalendarin e kaluar kanë ardhur në rritje. Mesatarisht kanë munguar 6 deputetë për mbledhje.

4. Gjatë kësaj periudhe është zhvilluar një seancë dëgjimore më datë 21.11.2006 me objekt diskutimi projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007" ku ka qenë i pranishëm edhe Ministri i Arsimit z. Genc Pollo.

Disa vlerësime: Edhe gjatë punimeve të këtij kalendarit është konstatuar një rritje e kohëzgjatjes së mbledhjeve. Kjo ka ndodhur edhe për faktin se gjatë këtyre mbledhjeve është diskutuar projektligji "Për buxhetin e shtetit". Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Në përgjithësi edhe në këtë komision konstatohet se deputetët gjatë shqyrtimit të projektligjeve mbështeten kryesisht vetëm në ekspertizën e qeverisë dhe relacionin e projektligjit. Edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë më datë 21.11.2006 me objekt diskutimi projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007" në komision nuk kanë marrë pjesë grupe të interesit. I pranishëm ka qenë vetëm Ministri Arsimit z. Genc Pollo dhe specialistë të kasëj ministrie.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

1. Gjatë periudhës 6-27 nëntor 2006 Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar por nuk janë respektuar datat për zhvillimin e tyre. Objekti i mbledhjeve ka qenë i parashikuar dhe nuk është ndryshuar. Në 6 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 330 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 55 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Në mbledhjen e datës 15.11.2006 me objekt diskutimi projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007" kanë qenë të pranishëm edhe ministat Genc Ruli, Luftër Xhuveli dhe Lulzim Basha. Po kështu edhe në mbledhjen e datës 14.11.2006 ka qenë i pranishëm ministri i Bujqësisë z. Jemin Gjana. Në mbledhjet e tjera qeveria është përfaqësuar edhe nga zëvendësministrat dhe specialistë të qeverisë të cilët kanë qenë gjithmonë të pranishëm. Në asnjë rast nuk kanë qenë të pranishëm përfaqësues të grupit të interesit. Gjatë punimeve të këtij kalendarit është konstatuar se pjesa më e madhe e deputetëve kanë qenë aktiv dhe të informuar për projektligjet e diskutuara. Në 6 mbledhje të realizuara numërohen 36 diskutime të zhvilluara nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 5 amendamente të cilat kanë qenë të natyrës teknike.

3. Edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të deputetëve në mbledhje. Mesatarisht mungojnë 5 deputetë për çdo mbledhje. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe disa deputetë kanë ardhur me vonesë në mbledhje dhe janë larguar pa përfunduar mbledhja. Në mbledhjen e datës 20 nëntor 2006 mbledhja ka filluar pa u plotësuar kuorumi me 6 deputetë prezent, ndërsa në mbledhjen e datës 22 nëntor kanë qenë të pranishëm në fillimin e mbledhjes vetëm 7 deputetë.

4. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media. Nuk ka patur pengesa për të marrë

pjesë në mbledhje. Gjatë punimeve të këtij kalendarit nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore.

Disa vlerësime: Siç rezultojnë nga monitorimi krahasuar me punimet e kalendarit të kaluar Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar 2 mbledhje më shumë. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar se në asnjë mbledhje nuk kanë marrë pjesë përfaqësues të grupit të interesit. Gjatë këtyre tri javëve në mbledhjet e këtij komisioni kanë marrë pjesë edhe 4 ministra. Edhe gjatë kësaj periudhe në këtë komision janë konstatuar mungesa të deputetëve. Krahasuar me tre javët e kaluara konstatohet një pjesëmarrje më e gjerë e deputetëve në diskutime dhe debate. Janë zhvilluar më shumë diskutime dhe deputetët kanë qenë më të informuar.

Disa vlerësime të përgjithshme për komisionet e monitoruara: Krahasuar me punimet e kalendareve të para të këtij sesioni në të gjitha komisionet është konstatuar një rritje e numrit të mbledhjeve si dhe të kohëzgjatjes së tyre. Gjatë kësaj periudhe krahas projektligjeve të tjera të gjitha komisionet kanë pasur për objekt diskutimi projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Komisioni për Ekonominë dhe Financat duke qenë edhe komisioni përgjegjës për projektligjin ka zhvilluar më shumë mbledhje të cilat kanë zgjatur mesatarisht 95 minuta. Gjatë zhvillimit të këtyre mbledhjeve ka pasur shumë diskutime dhe debate. Në disa raste këto debate kanë degraduar deri në fyerje dhe kjo ka ndodhur në prani të medias.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është konstatuar një pjesëmarrje më aktive e deputetëve në diskutime. Në ndryshim nga periudhat e tjera shumica e deputetëve kanë qenë të informuar paraprakisht për projektligjet e rëndësishme. Edhe gjatë kësaj periudhe deputetët nuk rezultojnë të kenë informacion paraprak për projektligjet me objekt ratifikim marrëveshjesh ndërkombëtare. Ky fakt konstatohet në mënyrën e kalimit të tyre pa pyetje dhe pa zhvilluar asnjë debat.

Edhe pse gjatë këtyre tri javëve objekt diskutimi në komisione ka qenë projektligji "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", grupet e interesit nuk kanë marrë pjesë në mbledhje. Të pranishëm kanë qenë përfaqësuesit e qeverisë deri në nivel ministrash. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Një interes të veçantë gjatë këtyre tri javëve ka treguar edhe media e cila ka qenë e pranishme në të gjitha mbledhjet e zhvilluara. Gjatë monitorimit të punimeve të këtij kalendarit janë konstatuar përsëri mungesa të shumta të deputetëve si dhe raste kur deputetët vijnë me vonesë dhe largohen pa përfunduar mbledhja. Përgjatë bën Komisioni i Ekonimisë dhe Financave në mbledhjet e të cilit është konstatuar një rritje e pjesëmarrjes së deputetëve.

Janë konstatuar përsëri raste kur mbledhja fillon pa u plotësuar kuorumi.

*Lindita Troka
Florjan Kalaja
Klesta Hysi
Ermal Markaj*

RASTE VËZHGIMI: PROCESI I SHQYRTIMIT TË PROJEKTLIGJEVE TË VEÇANTA

(Vijon nga faqja 1)

kohëzgjatje në total prej 85 minutash. Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në mbledhjet e komisionit kanë marrë pjesë Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Genc Ruli; Kryetari i Dhomës së Tregtisë Luan Bregasi si dhe përfaqësues të OSBE-së.

Sipas raportit të përgatitur nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin nevoja e hartimit të një projektligji të ri ka lindur nga mangësitë e vërejtura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues dhe si pasojë e zhvillimit ekonomik të vendit dhe veçanërisht të biznesit privat. Ky projektligj synon rritjen e nivelit të përfaqësimit, përmirësimin e funksionimit dhe rritjen e gamës së shërbimeve të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, duke përafuar kështu funksionimin e tyre me ato të vendeve të BE-së. Projektligji përcakton në mënyrë unike, për të gjitha Dhomat, objektin e tyre të veprimtarisë, kompetencat e saj, rolin e Dhomës si një Institucion në shërbim të biznesit. Projektligji parashikon organizimin dhe funksionimin e Dhomave në bazë qarku duke i bërë ato më efektive dhe më përfaqësuese dhe lihet hapur në statut mundësia për zyra përfaqësimi në njësitë teritoriale të qarkut, kur shihet e nevojshme. Gjithashtu projektligji saktëson rolin dhe kompetencat e organeve të Dhomës dhe të organit mbikqyrës, si dhe rolin, kompetencat dhe organizimin e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë. Pas diskutimeve dhe shqyrtimit nën për nen deputetët me shumicë votash votuan pro kalimit të projektligjit për miratim në seancë plenare.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në mbledhjet e tij më datë 25 tetor dhe 1 nëntor 2006 ka shqyrtuar projektligjin "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë". Sipas raportit për dhënie mendimi të përgatitur nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut deputetët u shprehën se projektligji është në përputhje me Kushtetutën. Gjatë shqyrtimit të projektligjit nën për nen, komisioni bëri disa dryshime të natyrës tekniko-legjislative dhe e miratoi projektligjin me shumicë votash.

Si burim informacioni gjatë shqyrtimit të këtij projektligji kanë shërbyer ekspertiza e përfaqësuesve të qeverisë, si dhe mendimet dhe sugjerimet e bëra nga grupet e interesit të përfaqësuar nga Dhomat e Tregtisë. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në komisione janë bërë 5 amendamente të cilat nuk prekin thelbin e projektligjit të paraqitur nga qeveria, por janë të karakterit teknik (riformulime të neneve të veçanta). Projektligji është shqyrtuar në një seancë plenare përkatësisht më datë 9.11.2006. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në seancë ka patur shumë debate. Opozita ka kërkuar që ta kthejë mbrapsht projektligjin. Gjithashtu ka patur edhe një amendament të paraqitur nga një deputet por ai nuk është marrë në konsideratë sepse deputeteti propozues nuk e kishte depozituar atë paraprakisht me shkrim. Projektligji është miratuar me 71 vota pro më datë 9.11.2006.

Projektligji "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007"

Projektligji "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007" është depozituar në Kuvend më datë 25.10.2006 dhe është përfshirë në programin e punimeve të Kuvendit më datë 6.11.2006. Ky projektligj është paraqitur nga Këshilli i Ministrave. Është parashikuar që të shqyrtohet në kalendarin 3-javor të periudhës 6 – 27 nëntor 2006.

Komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji është Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Është

parashikuar që të japin mendim edhe Komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave më datë 1.11.06 ka zhvilluar mbledhjen e tij të parë me objekt shqyrtimin e projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Nga ky komision janë zhvilluar gjithsej 9 mbledhje me një kohëzgjatje totale prej 850 minutash ose mesatarisht 95 minuta për mbledhje.

Si burim informacioni gjatë shqyrtimit të këtij projektligji është shfrytëzuar vetëm ekspertiza e përfaqësuesve të qeverisë, e cila në disa raste është përfaqësuar edhe nga ministrat. Në mbledhjet e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave por as në mbledhjet e komisioneve të tjera gjatë shqyrtimit të projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007" nuk kanë qenë të pranishëm përfaqësues të grupeve të interesit.

Sipas raportit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave pas miratimit në parim të projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007" komisioni e ka shqyrtuar atë nën për nen. Në mbledhjet e komisionit ka qenë i pranishëm zëvendësministri i financave me stafin e tij, për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të deputetëve për nenet e projektligjeve. Komisioni dëgjoi shpjegimet e disa ministrave si: Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit; Ministri i Punës, Përkrahjes Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe zëvendësministri i Brendshëm përgjegjës për Pushtetin Vendor.

Në këto mbledhje u shqyrtuan edhe raportet e komisioneve të përhershme të Kuvendit për vlerësimin nën për nen të projektligjit dhe u bënë përpjekje për të plotësuar disa nga kërkesat dhe amendamentet për shtimin e shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Komisioni shqyrtoi edhe amendamentet e paraqitura nga Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Socialdemokrate për shtimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit me 8.5 miliardë lekë. Në këto amendamente propozohet të rriten të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar me 5 miliardë lekë, nga tatimi mbi fitimin me 3 miliardë lekë dhe 0.5 miliardë lekë nga tatimi mbi të ardhurat personale, si dhe të shtohen shpenzimet për investime në bujqësi, në turizëm, për rininë dhe sportin, për institucionet e pavarura, etj. Shumica e deputetëve të komisionit nuk ra dakord me shtimin e të ardhurave të propozuar nga deputetët e LSI-së dhe PSD-së, duke e konsideruar këtë rritje të pabazuar në argumenta ekonomike e financiare e të pamundur për tu realizuar. Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit dhe ndryshimeve të disa neneve komisioni me shumicë votash e miratoi projektligjin për ta paraqitur në seancë. Deputetët e opozitës abstenuan gjatë votimit të projektligjit në komision.

Projektligji është shqyrtuar në dy seanca plenare. Në seancën e datës 13.11.06 e cila ka zgjatur 7 orë e 30 minuta projektligji është miratuar në parim me 79 vota pro, 53 kundër dhe 1 abstenim. Gjatë kësaj seance ka pasur shumë debate dhe diskutime ndërmjet deputetëve. Në seancën e datës 27.11.2006 projektligji është shqyrtuar nën për nen dhe po në këtë seancë është miratuar në tërësi me 72 vota pro.

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN NËNTOR 2006

I. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 16.11.2006

VENDIME për propozim projektligjesh

1. Për Propozimin e projektligjit "Për Ratifikimin e Marrëveshjes, së Kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për pjesëmarrje në financimin e projektit "Ndërtimi i Urës së Bunës, Shkodër".

2. Për propozimin e projektligjit "Për Ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe INALCA SPA, CASTELVETRO di Modena (Itali), dhe ALMED, SRL, Trieste (Itali), për riskedulimin e borxheve te prapambetura".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 16.11.2006

1. Projektligj "Për Ratifikimin e Marrëveshjes, së Kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për pjesëmarrje në financimin e projektit "Ndërtimi i Urës së Bunës, Shkodër".

2. Projektligj "Për Ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe INALCA SPA, CASTELVETRO di Modena (Itali), dhe ALMED, SRL, Trieste (Itali), për riskedulimin e borxheve te prapambetura".

3. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Brendshme.

4. Për miratimin e Programit Ekonomik e Fiskal, të Shqipërisë, për periudhën 2006-2008.

5. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Fushë-Bulqizë, të Qarkut të Dibrës.

6. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Delvinë, të Qarkut të Vlorës.

7. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Gradishtë, të Qarkut të Fierit.

8. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Luzni, të Qarkut të Dibrës.

9. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Pojan, të Qarkut të Korçës.

10. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Luftinjë, të Qarkut të Gjirokastrës.

11. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Gjinaj, të Qarkut të Kuksit.

12. Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të "Depo Drithi Nr.2, (Magazinë), të Rezervave të Shtetit, Agjencia Lundër", nga Ministria e Brendshme Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

13. Për miratimin, në parim, të Programit për Bashkëpunimin në Fushën e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për periudhën 2007-2009.

14. Për hapjen e ciklit të dytë të studimeve "Master", pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës.

15. Për miratimin e strategjisë kombëtare të rinisë dhe planit kombëtar të veprimtimit.

16. Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2007, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit të Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

17. Për miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, për zgjidhjen e Borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Bullgarisë.

18. Për miratimin, në parim, të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Polonisë, për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Polonisë.

19. Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla, për vitin 2006.

2. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 22.11.2006

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 22.11.2006

1. Për një ndryshim në Vendimin Nr. 335, datë 2.9.1997, të këshillit të Ministrave, "Për Lëshimin e Pasaportave Diplomatike dhe Shërbimit". Të ndryshuar.

2. Për miratimin, në parim, të letërmarrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për përdorimin e fondeve të mbetura nga kredia e Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për financimin e projektit të Transmetim-Shpërndarjes së energjisë elektrike.

3. Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël.

4. Për rishpërndarje fondësh buxhetore nga Ministria e Shëndetësisë Akademisë së Shkencave.

5. Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të strukturës e të nivelit të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të këshillit kombëtar të kontabilitetit.

6. Për një ndryshim në Vendimin Nr.542, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Institutit të Statistikave të disa mjediseve, për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni".

3. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 27.11.2006

VENDIME për propozim projektligjesh

1. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e Kontratës Financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 27.11.2006

1. Për dhënie shtesë fondi Komunës Lopës, të Qarkut të Gjirokastrës, për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi i depove me municion luftarak.

2. Për një shtesë fondinë buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e veprimtarisë të CRANS MONTANA FORUM.

3. "Për ratifikimin e Kontratës Financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim".

4. Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve.

5. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesës së shpenzimeve për kurimin në Itali, të z. Bashkim Gazidede.

6. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesës së shpenzimeve për kurimin, në Itali, të znj.Mimoza Dhëmbi.

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

PROJEKTLIGJ

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore.

2. Garantimin e mbrojtjes ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Neni 2

Objektivat

1. Ky ligj ka si objektiva:

a) Krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjës për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;

b) Orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;

c) Fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;

d) Sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit;

2. Veprimtaria e të gjithë personave dhe organeve të ngarkuara me zbatimin e këtij ligji, në ushtrimin e funksioneve të tyre, udhëhiqet nga qëllimet e parashikuara në nenin 1.

Neni 3

Përkufizimet

Në kuptimin e këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. Me "Dhunë" kuptohet çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik të individit (ndaj të cilit është ushtruar dhuna).

2. Me "Dhunë në familje" kuptohet:

a. Çdo akt dhune e ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare;

b. Veprimet apo mosveprimet, të cilat konsiderohen si dhunë në familje janë, por nuk kufizohen, si më poshtë:

¹Vrasja, kanosja, tortura, plagosja, ndërprerja e shatzënisë, mosdhënia e ndihmës, shkaktimi i vetëvrasjes, rrëmbimi, trafikimi, dhunimi i banesës, detyrimi dhe shfrytëzimi i prostitucionit, fyerja, shpifja, kufizimi i lirisë së shprehjes, qarkullimit apo të organizimit, përcërimi, cënimi i jetës private, dhunimi seksual, kryerja e veprimeve të tjera të turpshme, kërcënimi për braktisje, mosdhënia e mjeteve për jetesë, marrja e padrejtë e fëmijës, abuzimi i drejtpërdrejtë fizik, psikologjik, seksual dhe ekonomik i fëmijëve, vendosja e këtyre të fundit në situata të rrezikshme apo dëshmitarë të dhunës ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes, shtrëngimi për bashkëjetesë/zgjidhje martesë, cënimi i pasurisë dhe i mirëqenies ekonomike, kufizimi në administrimin e të ardhurave apo pengimi në mbajtjen e mjeteve monetare.

3. Me "Pjesëtarë të familjes" kuptohet²²

(sipas ligjit gjerman):

c. Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja;

d. Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;

e. Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i/e personave të parashikuar në paragrafin (pikën) b,

f. Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;

g. Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit.

4. Me "Viktimë" kuptohet personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

5. Me "Autoritet Kryesor Përgjegjës" në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative kuptohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta - Drejtoria për Parandalimin dhe Reduktimin e Dhunës në Familje;

6. Me "Autoritete Përgjegjëse të Linjës" kuptohen Ministria e Brendshme (dhe strukturat në varësi të saj si Drejtoritë e Policisë); Ministria e Shëndetësisë (dhe strukturat në varësi të saj si Urgjencat); Njësitë e Qeverisjes Vendore si Bashkitë dhe Komunat. dhe strukturat në varësi të tyre si: Drejtoritë e Policisë, Urgjencat për rastet e dhunës në familje dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki, komuna);

7. Me "Urdhër mbrojtjeje" kuptohet urdhri i lëshuar me vendim gjykatë ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën;

8. Me "Urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje" kuptohet urdhri i lëshuar për kohësisht me vendim gjykatë, deri në lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykatë.

Neni 4

Subjektet

Subjektet që mbrohen nga ky ligj, janë të gjithë ata persona të cilët pësojnë dhunë në mjediset dhe marrëdhëniet familjare (në përputhje me nenin 3 të këtij ligji). Të gjithë personat e tjerë, pjesëtarë të familjes me të cilët viktimat ka ose ka pasur lidhjet e treguara në nenin 3/3 të këtij ligji.

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5

Autoritetet Përgjegjëse

1. Autoriteti Kryesor Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është: "Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta (M.P.Ç.S.SH.B.) - Drejtoria për Parandalimin dhe Reduktimin e Dhunës në Familje";

2. Autoritete të tjera Përgjegjëse të Linjës janë:

a. Sektorët e Shërbimeve Sociale të Njësiteve Vendore,

b. Drejtoritë e Policisë që janë në varësi të Ministrisë së Brendshme si dhe

c. Qendrat Shëndetësore që janë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 6

Objektivat e Autoritetit Kryesor Përgjegjës

1. Në mbështetje të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative dhe për zbatimin e tyre "Autoriteti Kryesor Përgjegjës" ka këto objektiva:

a) Mbështetjen dhe mbrojtjen e marrëdhënieve familjare dhe vlerave dhe siç janë respekti, dashuria, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ndërmjet pjesëtarëve të familjes, në parandalimin dhe marrjen e masave ndaj dhunës në familje;

b) Përkrahjen e pjesëtarëve të familjes në nevojë, si pasojë e dhunës në familje;

c) Mbështetjen e viktimave të dhunës në familje përmes kurimit shëndetësor dhe programeve të rehabilitimit social.

d) Ndihmën ndaj shkaktarëve të dhunës në familje, duke ndërmarrë trajtime të ndryshme shëndetësore dhe sociale;

(Vijon në faqen 7)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

(Vijon nga faqja 6)

e) Mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sidomos të miturit, gratë dhe të moshuarit, duke ruajtur privatësinë e tyre;

f) Hartimin e strategjive dhe politikave, me synim parandalimin dhe marrjen e masave ndaj dhunës në familje;

g) bashkëpunimin me organet e tjera përgjegjëse të linjës si dhe me OJF-të e licensuara për të marrë masa konkrete ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare dhe kontrollin e zbatimit prej tyre të strategjive dhe politikave të hartuara në këtë drejtim.

2. Shteti krijon kushte për hartimin dhe realizimin e strategjive dhe programeve për parandalimin e dhunës në familje; për mbështetjen dhe ndihmën për viktimat e dhunës në familje; gjithashtu do ta përfshijë këtë subjekt në programet që kanë të bëjnë me shërbimet sociale.

Neni 7

Varësia dhe funksionimi i Autoritetit Kryesor Përgjegjës

1. Strukturat drejtuese dhe punonjësit e tjerë pranë "Autoritetit Përgjegjës" gëzojnë statusin e nëpunësit civil, duke iu referuar ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil". Autoriteti Përgjegjës është në varësi të M.P.Ç.S.SH.B., e cila ngarkohet për krijimin e një sektori të veçantë në nivel drejtorie për luftën dhe parandalimin e dhunës në familje.

2. Përbërja, detyrat, funksionimi dhe financimi i këtij autoriteti bëjnë pjesë në strukturën e M.P.Ç.S.SH.B.

Neni 8

Detyrat e Autoritetit Kryesor Përgjegjës

Autoriteti Kryesor Përgjegjës ka këto detyra:

a) Hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

b) Kontrollin e zbatimit të rregullave në fushën përkatëse si dhe aktivitetin e të gjithë Njësive të Qeverisjes Vendore në rang Republike;

c) Financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes si edhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

d) Mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse si dhe të gjithë infrastrukturës së nevojshme që shërben për një mbështetje dhe plotësim të të gjitha nevojave për personat e dhunuar në marrëdhëniet familjare, *përfshi këtu asistencë financiare si dhe shërbime mjekësore dhe sociale*. Këto subjekte do të përfshihen në asistimin që u bëhet personave në nevojë konform ligjit "Për shërbimin social në R.SH."³.

e) Organizimin e kurseve të trajnimit rreth dhunës në familje, me punonjësit e shërbimeve sociale që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e OJF-ve të licensuara për ofrimin e shërbimeve sociale;

f) Mbajtjen e të dhënave statistikore për nivelin e dhunës në familje;

g) Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;

h) Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;

i) Licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit.

Neni 9

Detyrat e Autoriteteve Përgjegjëse të Linjës

1. Ministria e Brendshme ka këto detyra:

a) Krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë Drejtorive të Policisë;

b) Trainimin e efektivave të policisë që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje.

2. Ministria e Shëndetësisë ka për detyrë të krijojë kapacitetet e duhura për të përballuar rastet e dhunës në familje në shërbimet e Urgjencës dhe pranë Qendrave të kujdesit Shëndetësor në bashki dhe komuna:

a) Për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje;

b) Për të bërë ekzaminimet përkatëse në çdo vend dhe në çdo kohë;

c) Për të evidentuar rastet e dhunës në familje në regjistrat përkatës mjekësorë;

d) Për të pajisur edhe viktimën me një kopje të aktit të ekspertizës mjeko-ligjore;

e) Për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbi-
meve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

3. Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkitë, Komunat) kanë këto detyra:

a) Angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje;

b) Instalimin e një linje telefonike rajonale 24 orësh, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore, dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre;

c) Ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit si dhe koordinimin e punës me ato ekzistente duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Neni 10

Përgjegjësitë e Autoriteteve Përgjegjëse

1. Drejtorja për Parandalimin dhe Reduktimin e Dhunës në Familje, Njësitë e Qeverisjes Vendore, Drejtoritë e Policisë, Qendrat Shëndetësore janë të *detyruara* me ligj të bashkërendojnë punën e tyre në mënyrë që pavarësisht se kush është i pari që merr dënimin për dhunën kundrejt një subjekti, të marrë masa për vënien në lëvizje të të gjitha strukturave që shërbejnë për përballimin e situatës së krijuar si dhe për procedimin e mëtejshëm ligjor.

2. Secili nga autoritetet e mësipërme ka për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga M.P.Ç.S.SH.B.

3. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë, apo dhe në rastet e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes, apo urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës apo shoqëruesit të saj.

4. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:

a. Informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet;

b. Informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimit në qendrat dhe institucionet përkatëse;

c. Sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;

d. Vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.

5. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje ose ka thyer urdhrat e mbrojtjes të lëshuar me vendim gjykatë, komisariatet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.

6. Personat të cilët marrin dënimin për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe

(vijon në faqen 8)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

(Vijon nga faqja 7)

nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale duke aplikuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të K.P.

Neni 11

Subjektet që mund të venë në dijeni organet përgjegjëse 1. Në rast të dhunës në familje, viktimat mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë, Komisarariatit më të afërt të Policisë (të zonës ku banon ose ndodhet), Njësisë përkatëse Vendore (komunë, bashki), Qendrës Shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj apo të dhunuesit/es, për të marrë masat e nevojshme.

a. Në rast të konstatimit të rastit të dhunës në familje, i afërmi, fqinji, mësuesi/ja mund t'u drejtohen me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

b. Gjithashtu edhe vetë organet e policisë kanë për detyrë të bëjnë konstatimet përkatëse si dhe të fillojnë hetimet kryesisht.

KREU III

MASAT MROJTËSE

Neni 12

Masat Mbrojtëse ndaj Dhunës në Familje

a. Mbrojtja ndaj dhunës në familje në zbatim të këtij ligji do të sigurohet me këto mënyra:

a) Duke urdhëruar menjëherë të paditurin/en (dhunuesin/en) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprë të dhunës në familje ndaj paditësit/es (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b) Duke urdhëruar menjëherë dhunuesin/en që të mos cënojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt apo tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës;

c) Duke larguar menjëherë dhunuesin/en nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër të gjykatës dhe të mos e lejojë të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës;

d) Duke ndaluar menjëherë dhunuesin/en që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës;

e) Duke ndaluar menjëherë dhunuesin/en që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm apo të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

f) Duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

g) Duke kufizuar ose duke ndaluar dhunuesin/en të takohet me fëmijën e viktimës sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

h) Duke i ndaluar dhunuesit/es hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

i) Duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbartues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose dhunuesin/en deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

j) Duke urdhëruar dhunuesin/en që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku viktimat dhe dhunuesi/ja ose ndonjë pjesë të saj;

k) Duke urdhëruar dhunuesin/en që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

l) Duke ndaluar dhunuesin/en si dhe viktimën të shesë çdo pasuri të përbashkët brenda një periudhe të caktuar kohore;

m) Duke i kaluar viktimës të drejtën e kujdestarisë së përkohshme mbi fëmijët dhe duke i hequr përkohësisht përgjegjësinë prindërore dhunuesit/es;

n) Duke vendosur dhe duke urdhëruar sipas rastit (në kompetencë të gjykatës) ndërhyrjen e shërbimeve sociale, publike apo private të vendbanimit ose të një qendre të *ndërmjetësimit familjar* apo pranë organizatave që kanë si qëllim mbështetjen dhe pritjen e personave të dhunuar në familje;

o) Duke urdhëruar dhunuesin/en që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

p) Duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

q) Duke urdhëruar dhunuesin/en të marrë pjesë në programe rehabilitimi;

b. Në urdhrin e mbrojtjes të lëshuar me vendim gjykate mund të parashikohen disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në paragrafin e parë.

c. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar me vendim gjykate mund të parashikohen disa nga masat e parashikuara në pikat a-i të këtij neni.

Neni 13

Efektet e Urdhrit të Mbrojtjes

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucioni tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e mësipërme do të nxirret me vendim gjykate për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i nxjerrë me vendim gjykate, apo përfundimi i efekteve të tij nuk çënon të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV

GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDRIT TË MBROJTJES

Neni 14

Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata civile, seksioni familjar.

2. Gjykata kompetente për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e rrethit në adresën aktuale ose në qendrën e punës të viktimës ose në rrethin në të cilin është bërë kërkesa për vendosjen e tij.

3. Gjykata, për lëshimin e urdhrave mbrojtës të përmendur në nenin 12 të këtij ligji, me vendim lëshon urdhra mbrojtjeje, dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

4. Pala e interesuar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate.

5. Në rastet kur gjykata me vendim ka lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë më pas lëshimin e një urdhri mbrojtës përfundimtar, përmes të cilit, lihet në fuqi urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes si dhe parashikohet marrja e masave mbrojtëse të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

(Vijon në faqen 9)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

(Vijon nga faqja 8)

Neni 15

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - a. Vetë viktimën;
 - b. Përfaqësuesi ligjor ose Avokati i viktimës;
 - c. Policia / Prokuroria.
2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:
 - a. Prindi ose kujdestari i të miturit;
 - b. Përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
 - c. Të afërmit;
 - d. Përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë ose Komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimën, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;
 - e. Qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/liçencuara pranë Drejtorisë së Parandalimit dhe Reduktimit të Dhunës në Familje.
3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:
 - a. Vetë viktimën;
 - b. Përfaqësuesi ligjor ose Avokati i viktimës;
 - c. Policia/Prokuroria;
 - d. personi me të cilin viktimën ka marrëdhënie familjare;
 - e. Përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë ose Komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimën, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës.
 - f. Qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/liçencuara pranë Drejtorisë së Parandalimit dhe Reduktimit të dhunës në familje.

Neni 16

Forma e Kërkesë-Padisë

1. Kërkesë-padia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, përveç sa është parashikuar në nenin 154 të K.P.C., duhet të përbajë edhe:
 - a) Të dhëna personale, rreth familjes ose marrëdhënieve fafaisnore mes viktimës dhe dhunuesit;
 - b) Përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cënimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga dhunuesi/ja (të parashikuara në nenin 3/1 dhe 2 të këtij ligji)
 - c) Masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;
 - d) Nënshkrimin e kërkuarit.
2. Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet pranë komisarariatit më të afërt të policisë.
3. Për hartimin e kërkesë-padisë, përgatitjen e akteve dhe paraqitjen e tyre në gjykatë kërkuesi asistohet nga një avokat *falas*.
4. Kërkuesi shkarkohet nga taksat e gjykatës. Me daljen e urdhrin të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Në rast të kundërt shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.
5. Kërkesë-padia regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj.

Neni 17

Thirrja për në Gjyq

1. I padituri për ushtrim dhune thirret nga gjykata me anë të fletë-thirrjes.

2. Përmbajtja e fletë-thirrjes dhe rregullat e njoftimit janë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Neni 18

Provat në Procesin Gjyqësor

1. Në procesin për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, barra e provës i përket dhunuesit/es.
2. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-eksperimenti, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF) të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.
3. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisarariatet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shpresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rast të moslëshimit të dokumentit të mësipërm, personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative.
4. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 19

Gjykimi për Lëshimin e Urdhrin të Mbrojtjes

1. Gjykata vendos shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes brenda 15 ditësh pas pranimit të kërkesës.
2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:
 - a) Viktimën , përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
 - b) Dhunuesin/en, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
 - c) Prokurorin , nëse ka bërë kërkesë;
 - d) Përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë njësive në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;
 - e) Punonjësit e Qendrave Shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;
 - f) Dëshmitaret, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm,
3. Seanca gjyqësore zhvillohet në mungesë të dhunuesit, nëse ky i fundit është thirrur sipas rregullave të caktuara procedurale.
4. Në rast të mosparaqitjes në seancë gjyqësore për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes të kërkuesit apo përfaqësuesit të tij ligjor, pa njoftuar gjykatën paraprakisht për arsyet e mungesës, gjykimi pushohet duke i rezervuar kërkuesit të drejtën e paraqitjes përsëri të së njëjtës kërkesë.

Neni 20

- Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes
1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 12 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, nëse vërtetohet se:

(Vijon në faqen 10)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

(Vijon nga faqja 9)

a) Ekzistojnë bazat për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje (parashikuar në nenin 3 të këtij ligji),

b) Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes me vendim gjyqate është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave direkte dhe indirekte, urdhër në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

2. Pavarësisht nëse ekziston apo jo ndonjë proces penal ndaj dhunuesit/es, gjykata nuk paragjykon lëshimin e vendimit të urdhrit të mbrojtjes.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes përmban:

a) Masën e caktuar nga gjykata;

b) Kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;

c) Njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes të lëshuar me vendim gjyqate përbën vepër penale në kuptim të Nenit 320 të K. P.;

d) Njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes të lëshuar me vendim gjyqate brenda 15 ditësh nga shpallja apo marrja dijani e tij;

4. Urdhri i mbrojtjes i lëshuar me vendim gjyqate i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore.

5. Gjykata, brenda 24 orësh pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjyqate u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) Viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) Prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;

c) Zyrës së Shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

d) Komisarariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

6. Urdhri i mbrojtjes i lëshuar me vendim gjyqate hyn në fuqi menjëherë dhe fillon të zbatohet ndaj dhunuesit pavarësisht nëse ka marrë dijani ose jo.

a) Ekzistojnë bazat për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje (parashikuar në nenin 3 të këtij ligji), apo,

b) Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes me vendim gjyqate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave direkt dhe indirekt, urdhër në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

Neni 21

Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme brenda 24 orësh pas parashtrimit të kërkesës.

2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjojnë personat në vijim:

a. Viktimat, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;

b. Dhunuesi/ja, përfaqësuesi apo avokati i tij/saj;

c. Prokurori nëse merr pjesë;

d. Kërkuesit e tjerë, të parashikuar në nenin 15 të këtij ligji;

e. Dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 22

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, nëse konstaton se:

a. Ekzistojnë bazat për të besuar se dhunuesi/ja ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;

b. Dhunuesi/ja paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

c. Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjyqate është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës që mbrohen me anë të urdhrit të mbrojtjes.

2. Pavarësisht nëse ekziston apo jo ndonjë proces penal ndaj dhunuesit, gjykata nuk paragjykon vendimin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përmban:

a. Masën e caktuar nga gjykata;

b. Kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;

c. Njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën vepër penale, në kuptim të nenit 320 të K.P.;

d. Njoftimin për të drejtën e ankimit kundër vendimit brenda 5 ditësh nga shpallja apo marrja dijani e tij;

e. Datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditësh prej lëshimit të tij me vendim gjyqate.

4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i lëshuar me vendim gjyqate i dërgohet menjëherë dhunuesit/es.

5. Gjykata, brenda 24 orësh pas lëshimit të tij u dërgon nga një kopje të vendimit personave në vijim:

a. Viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b. Kërkuesve në kuptim të nenit 15 të këtij ligji;

c. Zyrës së Shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

d. Komisarariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (neni 510 e vijues).

Neni 23

Gjykimi për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

1. Pas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes mbi bazën e kërkesës në zbatim të nenit 19 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata:

a. Vendos anulimin si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjyqate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;

b. Refuzon lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjyqate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i lëshuar më parë me vendim gjyqate;

(Vijon në faqen 11)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

(Vijon nga faqja 10)

c. Lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykatë në bazë të nenit 20 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykatë.

Neni 24

Ankimi

1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankimi i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykatë mund të bëhet ankimi brenda afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrin të mbrojtjes.

Neni 25

Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktimi (përfaqësuesi i saj) ose prokurori mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes.

2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 19 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a. Lënien në fuqi të urdhrin të mbrojtjes;

b. Ndryshimin e urdhrin të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht ose

c. Ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 12.1 të këtij ligji nuk vlejné më për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes.

4. Viktima ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, mund të parashtrorë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrorë kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.

5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrin të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 19 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit, gjykata vendos:

a. Vërtetimin e ndërprerjes së urdhrin të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij, ose,

b. Vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, nëse vlejné kriteret e përcaktuara në nenin 20\1 të këtij ligji.

Neni 26

Ekzekutimi i Vendimit Gjyqësor

1. Vendimi gjyqësor, i cili përmban urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv, që në momentin që shpallet apo i njoftohet palëve.

2. Vendimi gjyqësor që përmban urdhrin e mbrojtjes, përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë nga Përmbaruesit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, Komisarariatet e Policisë dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashki, komuna) apo edhe vetë dhunuesi vullnetarisht.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 12 të këtij ligji.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licënuara për ofrim shërbimesh zbatojné masat e parashikuara në vendimin gjyqësor dhe koordinojné punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe Drejtoritë e policisë si ekzekutuese direkt e këtyre vendimeve.

5. Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të gjykatës bëhet nga Zyrat e Shërbimit Përmbarimor, konform dispozitave të K.Pr.Civile (neni 510 e vijues).

6. Në rast të mosëkzekutimit vullnetar nga subjektet, të cilave iu komunikohet vendimi, ndiqet ekzekutimi i detyruar në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto raste aplikohen sanksionet përkatëse të parashikuara në këtë ligj ndaj personave moszbatues të ligjit konform nenit 320/a të KP dhe si dhe sanksione të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile konform nenit 606/3 të K Pr C.

KREUV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Procedimi Penal

Lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykatë nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, përsa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.

Neni 28

Aktet Nënligjore

Në zbatim të këtij ligji, Autoriteti përgjegjës dhe organet e tjera përgjegjëse të linjës bëjnë rregullimet përkatëse nënligjore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 29

Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V.O. Mosrespektimi i vendimit për zbatimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrave të mbrojtjes nga vetë dhunuesi apo personat e tjerë zbatues të ligjit, do të parashikohen si vepra penale më vete (ndryshime në K.P.), në kuadrin e ndryshimeve në K.P apo ligje të tjera në momentin e kalimit të këtij ligji. Po ashtu ligji për Shërbimin shoqëror të specifikohet «Persona në nevojë», përfshihen dhe personat anëtarë të familjes të dhunuar, etj.

SHËNIME

¹ (varianti 1, sipas referimeve të KPRSH)

(Varianti 2 New Zeland):

abuzim fizik, abuzim seksual, abuzim psikologjik i cili përfshin dhe nuk kufizohet në:

kanosje, ngacmim, dëmtim të pronës, kërcënim për abuzim fizik, seksual ose psikologjik,

Në lidhje me të miturit përveç akteve të sipërcituara dhuna në familje kupton edhe:

vendosjen e fëmijës në situata të rrezikshme apo të qenit dëshimtar të akteve të dhunës ndaj personave të tjerë me të cilët i mituri është në marrëdhënie familjare,

(varianti 2)

a) Personat të cilët janë ose kanë qenë të lidhur ndërmjet tyre në marrëdhënie familjare, si fejesë, bashkëjetesë apo martesë;

b) Personat të cilët përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesore ose birësimi apo janë në marrëdhënie kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, mbesat, ungji dhe emta, ose të afërmit e tjerë me të cilët ato jetojnë;

³(kemi kërkuar që subjektet e dhunës në familje të jenë subjekt i ligjit të mësipërm).

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 1)

Për votim:

1. Projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin, kërkimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”.
2. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës, të Marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës”.
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Hagës, të Marrëveshjes së Hagës, për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960”.
4. Projektligji “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG, SHA-së”.
5. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.04.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar.

Veprimtari në Komisione – 30 Nëntor – 17 Dhjetor 2006

1. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e Programit të rehabilitimit të rrugës Shkodër-Hani i Hotit”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e Programit të rehabilitimit të Portit të Vlorës”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

· *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

3. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

· *Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë*

4. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.P.A., për Programin “Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar, për integrimin në sistemin e Ballkanit “Fuqizimim i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

· *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

5. P/Ligji “Për ratifikimin e ndryshimit në marrëveshjen e rishitjes së aksioneve të INSIG, SHA-së, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të Shtetit Shqiptar dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

6. P/Ligji “Për ratifikimin e një ndryshimi në marrëveshjen e Tregitës së Lirë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UMNIK), në emër të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës”.

· *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

· *Komisioni i Jashtëm*

· *Komisioni i Integritimit*

· *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

7. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe, ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Mi-

(Vijon në faqen 13)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 11)

sionit Administrativë të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Europian”.

- *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
 - *Komisioni i Jashtëm*
 - *Komisioni i Integritimit*

- *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

8. P/Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (paraqitur nga 20000 zgjedhës).

- *Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë*

- *Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

9. P/Ligji “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira” (grup deputetësh). (Është shtyrë në seancën plenare datë 1.06.2006 për ta shqyrtuar Komisioni i Ekonomisë dhe Financës).

10. P/Ligji “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

- *Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

- *Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

11. P/Ligji “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”.

· *Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë*

12. P/Ligji “Për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë të administratës dhe të zgjedhurve” (Depozituar nga grupi parlamentar i PD-së).

- *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

13. P/Ligji “Për verifikimin e të qenit bashkëpunëtor të shërbimeve sekrete shqiptare para datës 31.12.1992 të funksionarëve të lartë publikë”. (Depozituar nga grupi parlamentar i PS-së).

- *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

14. P/Ligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo emëruar nga organe të rëndësishme të shtetit”.

(Depozituar nga deputeti Nard Ndoka).

- *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

15. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 9179, datë 29.01.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”.

- *Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë*

- *Jep Mendim: Komisioni i Sigurisë Kombëtare*

16. P/Ligji “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

- *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

17. P/Ligji “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

- *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

18. P/Vendim “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

- *Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

- *Jep Mendim: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

19. P/Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7796, datë 17.2.1994 “Ligji Minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar.

- *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

20. P/Ligji “Për Konkensionet”.

- *Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë dhe Financës*

- *Jep Mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,*

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

21. P/Ligji “Për Policinë e Shtetit”.

- *Komisioni Përgjegjës: Komisioni për Sigurinë Kombëtare*

22. P/Ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

- *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

23. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

- *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

E Hënë, datë 4.12.2006, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).

(Vijon në faqen 14)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 13)

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 27.11.2006.

3. P/Ligji "Për ratifikimin e ndryshimit në marrëveshjen e rishitjes së aksioneve të INSIG, SHA-së, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të Shtetit Shqiptar dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)".

4. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë".

5. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

6. P/Ligji "Për dias shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë".

7. P/Ligji "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë".

E Enjte, datë 7.12.2006, ora 10.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 4.12.2006.

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e Programit të rehabilitimit të rrugës Shkodër-Hani i Hotit".

4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e Programit të rehabilitimit të Portit të Vlorës".

5. P/Vendim "Për miratimin e strukturës dhe organi-kës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

E Hënë, datë 11.12.2006, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 7.12.2006.

3. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa, S.P.A., për financimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe

Artigiancassa, S.P.A., për Programin "Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar, për integrimin në sistemin e Ballkanit "Fuqizimim i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit".

5. P/Ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira" (grup deputetësh).

6. P/Ligji "Për Policinë e Shtetit".

7. P/Ligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (paraqitur nga 20000 zgjedhës).

E Enjte, datë 14.12.2006, ora 10.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare datë 11.12.2006.

3. P/Ligji "Për ratifikimin e një ndryshimi në marrëveshjen e Tregitës së Lirë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UMNIK), në emër të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës".

4. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji Minerar i Shqipërisë", të ndryshuar.

5. P/Ligji "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".

E Hënë, datë 18.12.2006, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 14.12.2006.

3. Miratimi i Kalendarit të punimeve të Kuvendit.

4. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes shumë-palëshe, ndërmjet Komunitetit European dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativë të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit European".

5. P/Ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

6. P/Ligji "Për Konkensionet".

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org